



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 1.10.2024
Nr. 2847

Lënda: Informacion mbi konkluzionet e takimit konsultues me operatorët e shërbimit postar ndërkufitar

Drejtuar: **Partia Socialiste e Shqipërisë**
Rruga "Çamëria", Tiranë 1000.

Partia Demokratike e Shqipërisë
Bulevardi "Zhan D'Ark", 11, Tiranë.


Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
Pas Ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tiranë.

Partia e Lirisë
Rruga "Sami Frashëri", Godina 20/10, Tiranë.

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
Rruga "Skënderbej (Blloku i Ambasadave)", Tiranë.

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë
Rruga "Pjetër Budi" 6, Tiranë.

Partia Republikane e Shqipërisë
Rruga "Abdi Toptani" 2-10, Tiranë.



Të nderuar,

Në vijim të punës përgatitore që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po bën në kuadër të mundësisimit të Votimit nga Jashtë Vendit (VJV), në datën 24 Shtator 2024 zhvilloi një takim konsultues në nivel teknik me operatorët e shërbimit postar ndërkufitar. Nga përmbajtja e këtij takimi me qëllim realizimin e procesit të VJV vlerësoj se duhet të konsiderohet sa vijon:

1. Të gjithë ofruesit e shërbimit postar ndërkufitar bënë me dije se koha që ju duhet për dërgimin e fletëve të votimit nga Shqipëria, në adresat përkatëse të votuesve jashtë vendit është 45 ditë. Koha më e shkurtër, por që do ta vinte gjithësesi në vështirësi/pasiguri procesin është 30 ditë. Sikurse ju e dini afatet për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve, së bashku me kohën për prodhimin e fletëve të votimit datojnë rreth 10-12 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Në çdo rast jo më parë se 30 ditë përpara. Të gjithë operatorët përfshi edhe atë publik vlerësojnë se është e pamundur dërgimi i fletëve të votimit jashtë dhe kthimi i tyre në Shqipëri në një kohë më të shkurtër se 30 – 45 ditë. Praktikant e vendeve të tjera ku disa prej këtyre operatorëve janë angazhuar në votimin nga jashtë konfirmojnë afatin e dërgimit dhe të kthimit të fletëve të votimit nga jashtë, në një periudhë kohore jo më të pakët se 45 ditë.

2. Duhet përjashtuar kategorikisht alternativa e dërgimit të fletës nga votuesi drejt KQZ me postë të thjeshtë pasi kjo e fundit nuk ka gjurmim të asnjë lloji. Dërgesa rekomande disponon një barcode (standardi ndërkombëtar i stampimit elektronik të adresës dhe barcode unik identifikues të dërgesës) me anë të të cilit mund të gjurmohet përgjatë rrugëtimit. Edhe dërgesa ‘rekomande’ pavarësisht se lejon gjurmim, nuk ka prioritet si dërgesë. Kjo në kuptim të afateve. Me prioritet konsiderohen vetëm dërgesat me postë expres.

3. Nëse lihet në diskrecionin e zgjedhësit për të zgjedhur postën e kthimit, duhet përjashtuar opsioni i postës së thjeshtë, pasi nuk mund të gjurmohen dërgesat dhe ka shumë vonesa. Do të ishte me interes, për të maksimizuar pjesëmarrjen dhe kthimin e fletëve të votimit, që sikurse dërgimi, po ashtu edhe kthimi të bëhej i qendëruar me të njëjtën kompani të shërbimit postar nga ana e KQZ.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

